




REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E BUJQESISE, USHQIMIT DHE
MBROJTJES SE KONSUMATORIT
MINISTRI



Prot. 3348

URDHËR

**MBI DISA MASA PËR HYRJEN NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË TË PRODUKTEVE USHQIMORE**

Nr. *250* Datë *29.07* 2011

Ne mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 13 të ligjit 9863 datë 28.01.2008 "Për Ushqimin",

URDHËROJ

1. Produktet ushqimore të cilat importohen për konsum në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe kanë nje jetëgjatësi deri në 3 muaj, lejohen të hyjnë nëpërmjet Pikave të Inspektimit Kufitar (PIK) nëse në momentin e hyrjes ka mbetur jo më pak se 1/2 e afatit jetëgjatësise së tyre të deklaruar në etiketen ose dokumentin shoqërues.
2. Produktet ushqimore të cilat importohen për konsum në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe kanë nje jetëgjatësi deri në 1 vit, lejohen të hyjnë nëpërmjet PIK nëse në momentin e hyrjes ka mbetur jo më pak se 1/2 e afatit jetëgjatësise së tyre të deklaruar në etiketen ose dokumentin shoqërues.
3. Produktet ushqimore të cilat importohen për konsum në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe kanë nje jetëgjatësi me shume se 1 vit, lejohen të hyjnë nëpërmjet PIK nëse në momentin e hyrjes kane mbetur jo më pak se 6 muaj nga afati i jetëgjatësise së tyre të deklaruar në etiketen ose dokumentin shoqërues.
4. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen Drejtoria e Përgjithëshme e Politikave të Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.
5. Ky urdhër hyn në fuqi me datë 01.10.2011.

MINISTRI

GENC RULI

